

VENDIM
Nr.1142, datë 25.11.2009

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE DISA INSTITUCIONE NË VARËSI TË SAJ, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të drejtorisë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, Korçë, të bordit të kullimit, Korçë, të bordit të kullimit, Kukës, e të bordit të kullimit, Lushnjë, të realizojnë, brenda datës 15 dhjetor 2009, procedurat e prokurimit, me fondet e miratuara në buxhetin e këtij viti, për objektet e përcaktuara në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Brenda këtij afati të përfshihet edhe lidhja e kontratave përkatëse.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, institucionet në varësi të saj, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, Ministria e Financave e Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneks nr.1

Nr.	Autoriteti kontraktor	Fondi limit në lekë	Objekti i prokurimit	Shënim
1.	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	33 333 330	Vënie në zbatim të projektit të Intranetit, lidhja e MBUMK me institucionet e varësisë	Njoftim kontrate e lidhur
2.	Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Korçë	8 333 333	Shpenzime bujqësie – miu i arave	Njoftim fituesi dhe njoftim kontrate
3.	Bordi i kullimit, Korçë	7 341 000	Argjinatura në lumin Dunavec, Korçë	Njoftim kontrate e lidhur
4.	Bordi i kullimit, Kukës	5 830 000	Rehabilitim i rezervuarëve zona Has	Njoftim fituesi dhe njoftim kontrate
5.	Bordi i kullimit, Kukës	2 500 000	Rehabilitim i rezervuarëve zona Tropojë	Njoftim kontrate e lidhur
6.	Bordi i kullimit, Kukës	666 000	Studim, projektim të objekteve për vitet 2009-2010	Njoftim fituesi dhe njoftim kontrate
7.	Bordi i kullimit, Lushnjë	830 000	F.V. e 12 saraçineskave në 12 ujëlëshues të rezervuarëve	Njoftim fituesi dhe njoftim kontrate